



# Dëmet nga autoritetet publike: Rastet e paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve në gjykatë

## Hyrje

Të drejtat e qytetarëve për të kërkuar kompensim për dëmet e shkaktuara nga autoritetet publike janë kyçe për të siguruar drejtësi dhe respektim të të drejtave të njeriut, veçanërisht për grupet e cënueshme në shoqëri duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara. Ky raport, i bazuar në monitorimin e dy rasteve të personave me paraplegji dhe tetraplegji në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë, adreson sfidat me të cilat përballen grupet e cënueshme në realizimin e të drejtave të tyre. Ky raport i shkurtër strukturohet si në vijim: fillimisht diskutohet procedura gjyqësore për dëmet nga autoritetet publike, adresohen të dy rastet e monitoruara, dhe në fund paraqiten disa rekomandime konkrete për ndryshim të politikave, bazuar në gjetjet e monitorimit gjyqësor.

Personat paraplegjik dhe tetraplegjik janë përfitues të pensioneve dhe beneficioneve bazuar në legjislacionin në fuqi. Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik rregullon statusin dhe të drejtat e individëve të cilët për shkak të sëmundjes ose dëmtimit, kanë humbur në mënyrë të përhershme aftësinë për të lëvizur<sup>1</sup>) ekstremitetet e poshtme ose edhe 2) ekstremitetet e poshtme dhe ato të sipërme<sup>1</sup>. Ndërsa, Komisioni Vlerësues i përbërë nga ekspertë mjekësorë në bazë të Rregullores për Përbërjen, Funksionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik (në vijim: Rregullorja) brenda Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), shqyrton kërkesat e përfituesve të këtij ligji, përcakton statusin, kategorizimin dhe përfitimet e tjera sipas ligjit dhe rregullores<sup>2</sup>.

<sup>1</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. Nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. I qasshëm te: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12554>.

<sup>2</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. "Rregullore (ORK) nr. 07/2017 për përbërjen, funksionimin, përgjegjësitë e komisionit vlerësues dhe përcaktimin e procedurave për njohjen e statusit dhe të drejtave të personave paraplegjik dhe tetraplegjik" E qasshme te: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15161>.

Sipas Rregullores, përfituesit e grupit të parë janë individët me pasoja të përhershme dhe të plota, përfshirë inkontinencën dhe humbjen e plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve. Ndërsa përfituesit e grupit të dytë janë individë që nuk kanë pasoja të përhershme dhe të plota, përfshirë inkontinencën dhe humbjen e plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve. Personat e kategorizuar në grupin e parë marrin deri në 375 euro në muaj: 150 euro për vete, 150 euro për kujdestarin, dhe 75 euro të tjera për pako sanitare. Ndërsa ata në grupin e dytë marrin vetëm 150 euro në muaj, pasi supozohet se nuk kanë nevojë për kujdestar dhe pako sanitare.

Megjithatë, edhe pse paraplegjia dhe tetraplegjia në grupin e parë njihen si gjendje të përhershme, këta persona janë detyruar që t'u nënshtrohen procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit Mjekësor të MFPT-së, i cili sipas Rregullores bëhet çdo pesë vite për grupin e parë, ndërsa çdo tri vite për grupin e dytë. Bazuar në dy rastet e monitoruara, personave me paraplegji dhe tetraplegji fillimisht iu ishte njohur e drejta në grupin e parë. Megjithatë, pas rivlerësimit, ata e humbën këtë të drejtë. Në rastin e parë, personi u hoq plotësisht nga lista e përfituesve, ndërsa në rastin e dytë, personi u rikategorizua nga grupi i parë në grupin e dytë. Kjo nxjerr në pah problemet që sjellin vlerësimet e bëra nga Komisioni Mjekësor në kuadër të MFPT-së, si dhe cilësinë e dobët të këtyre vlerësimeve. Demokraci Plus (D+) ka ngritur këtë çështje vitin e kaluar në raportin "Kompensimi për personat paraplegjik dhe tetraplegjik nga autoritetet publike", i cili është bazuar në monitorimin e dy rasteve në Gjykatën Themelore në Prishtinë<sup>3</sup>.

## Procedura gjyqësore për dëmet nga autoritetet publike

Qytetarët të cilët pretendojnë se është shkelur ligji në dëm të tyre me rastin e vendimeve përfundimtare të autoriteteve publike, kanë mundësinë që të kërkojnë të drejtat e tyre përmes padive në Departamentin për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë, i cili ka juridiksion në gjithë territorin e Kosovës.

Këto raste trajtohen sipas Ligjit për Konflikte Administrative (LKA), i cili përcakton kompetencën, rregullat e procedurës si dhe përbërjen e gjykatave në tri-shkallshmërinë e saj (Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit, si dhe Gjykata Supreme) për të vlerësuar ligjshmërinë e veprimeve administrative. Kjo procedurë gjyqësore shërben jo vetëm për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimeve administrative, por gjithashtu të mbikëqyrë punën e organeve administrative në rastet kur këto të fundit marrin vendime lidhur me kërkesat dhe ankesat e palëve. Në këtë mënyrë synohet mbrojtja gjyqësore e të drejtave dhe interesave të qytetarëve, të cilat janë cenuar me vendime dhe veprime të organeve të administratës publike.

Sipas LKA, konflikti administrativ mund të inicohet vetëm kundër aktit administrativ të nxjerr në procedurën administrative në shkallë të dytë. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative nuk është e lejuar ankesa<sup>4</sup>. Ndërsa sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), palët mund të inicojnë padi në gjykatë edhe në rastet kur organet publike nuk vendosin lidhur me kërkesat apo ankesat e palëve në një afat të caktuar kohor, të cilën ligji e ka përcaktuar si "heshtje administrative"<sup>5</sup>.

<sup>3</sup> Demokraci Plus (2024) "Kompensimi për personat paraplegjik dhe tetraplegjik nga autoritetet publike" Raport i shkurtër politikash. I qasshëm te: [https://dplus.org/wp-content/uploads/2024/01/29-01-24\\_Kompensimi-per-personat-paraplegjik-dhe-tetraplegjike-nga-autoritetet-publike-1.pdf](https://dplus.org/wp-content/uploads/2024/01/29-01-24_Kompensimi-per-personat-paraplegjik-dhe-tetraplegjike-nga-autoritetet-publike-1.pdf).

<sup>4</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative. I qasshëm te: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2707>.

<sup>5</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. I qasshëm te: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>.

## Rastet në gjykatë

Në të dy rastet gjyqësore që përfshijnë individët paraplegjik dhe tetraplegjik, vendimet përfundimtare të të dy niveleve të autoritetit publik, MFPT-së, dhe më pas Komisionit të Ankesave brenda MFPT-së, janë kundërshtuar nga palët. Sipas tyre, gjatë rivlerësimeve mjekësore nga ana e Komisionit të MFPT-së, gjendja reale shëndetësore nuk është vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të saktë. Si rezultat i këtyre vendimeve, palët e dëmtuara kanë nisur procedura ligjore në gjykatë kundër MFPT-së duke kërkuar kompensim për dëmet e shkaktuara.

### Rasti 1

## Padia e N.S. kundër Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Departamenti i Pensioneve

Lidhur me këtë rast, gjykata vendosi meritore në favor të palës paditëse N.S., duke i njohur statusin e tij si person paraplegjik dhe tetraplegjik në grupin e parë dhe duke detyruar MFPT-në që të kompensojë atë për dëmin e shkaktuar.

Beteja ligjore e N.S. filloi në vitin 2020 kur Komisioni Mjekësor në kuadër të MFPT-së rivlerësoi gjendjen e tij duke e rikategorizuar atë nga grupi i parë, siç ishte njohur fillimisht, në grupin e dytë. Pas një viti, ankesa e tij u refuzua edhe nga organi i shkallës së dytë pranë MFPT-së, Komisionit të Ankesave.

Përballë kësaj situatë, N.S. ngriti padi në vitin 2021 duke kontestuar vendimet e MFPT-së, si dhe duke kërkuar njohjen e së drejtës për kompensim të plotë në grupin e parë, përfshirë pagesat retroaktive për shumatat e papaguara.

Pas dy vitesh pritjeje, çështja u soll më në fund në një seancë shqyrtuese në vitin 2023. Në këtë seancë i pranishëm ishte përfaqësuesi ligjor i N.S., ndërsa askush nga ana e MFPT-së, e cila më parë e kishte kundërshtuar padinë si të pa bazë. Gjykata vuri re se ankesa e N.S. ishte refuzuar pa asnjë arsyetim dhe nuk kishte marrë parasysh provat e paraqitura nga pala që kishte bërë ankesën. Si rrjedhojë, gjykata miratoi propozimin e përfaqësuesit të N.S. për të marrë ekspertizë mjekësore për të vërtetuar gjendjen faktike.

Rasti në gjykatë vazhdoi tutje me seancën e shqyrtimit kryesor në janar të vitit 2024. Gjatë kësaj seance, gjykata administroi provat, duke u mbështetur kryesisht në ekspertizën mjekësore të mjekëve nga Shërbimi Klinik Universitar i Kosovës. Sipas kësaj ekspertize, N.S. i takon grupit të parë të kategorisë së personave paraplegjik dhe tetraplegjik, si dhe ka nevojë për përkujdesje të një personi kujdestar.

Gjykata gjithashtu rishikoi vlerësimet e Komisionit Mjekësor të së paditurit, dhe gjeti mangësi të mëdha procedurale që i bënin vendimet e kontestuara të paligjshme. Këto mangësi qëndrojnë në shkeljet thelbësore të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Duke u bazuar në këto gjetje dhe ekspertizën mjekësore, gjykata konstatoi se vendimet e MFPT-së ishin të kundërligjshme.

Si përfundim, gjykata në vendimin e saj të datës 23 janar 2024<sup>6</sup>, anuloi vendimet e MFPT-së, njohu të drejtën e palës paditëse për pension në kategorinë e parë, si dhe detyroi autoritetin publik, MFPT-në që të kompensojë palën e dëmtuar N.S. në mënyrë retroaktive për të gjitha shumatat e papaguara, përfshirë interesin ligjor prej 8%.

<sup>6</sup> Vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr. 258/21, datë: 23.01.2024. I qasshëm te: [https://prishtine.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/PR\\_A\\_2021-022071\\_SQ.pdf](https://prishtine.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/PR_A_2021-022071_SQ.pdf).

## Rasti 2

### Padia e F.V. kundër Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Departamenti i Pensioneve

Në rastin e dytë, gjykata vendosi në favor të paditësit F.V., duke aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e palës paditëse. Gjykata njohu statusin e paditësit si person paraplegjik dhe tetraplegjik në grupin e dytë dhe urdhëroi MFPT-në që ta kompensojë paditësin në mënyrë retroaktive për pagesat e perealizuara që nga data e refuzimit të kësaj të drejte.

Megjithëse fillimisht F.V. iu kishte njohur e drejta në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, pas rivlerësimit nga ana e Komisionit Mjekësor, ai u hoq tërësisht nga lista e përfituesve të pensioneve dhe beneficioneve. Në korrik 2022, vendimi i shkallës së dytë të MFPT-së refuzoi ankesën e paditësit për kompensim, me konstatimin se ai nuk i plotësonte kushtet ligjore për vazhdimin e kësaj të drejte.

Më 1 gusht 2022, paditësi inicioi padi në gjykatë duke kërkuar anulimin e vendimeve kontestuese të të paditurës MFPT, si dhe njohjen e të drejtës së tij për pensionin e skemës për personat paraplegjik dhe tetraplegjik në grupin e parë që nga data e paraqitjes së kërkesës.

Pas dy vitesh që nga iniciimi i padisë, rastit i erdhi radha që të shqyrtohej në seancë. Në janar të vitit 2024, është mbajtur seanca e parë ku mori pjesë përfaqësuesi ligjor i paditësit F.V., ndërsa nga e paditura, MFPT, askush nuk ishte prezent. Gjykata aprovoi propozimin e palës paditëse për të caktuar një ekspertizë të re mjekësore të përbërë nga mjekët e certifikuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për të verifikuar gjendjen reale shëndetësore të paditësit F.V. Kjo pasi që gjatë analizës së provave, gjykata vuri re se vendimet e Komisionit të MFPT-së nuk kishin dhënë arsye të mjaftueshme dhe nuk kishin marrë parasysh asnjë provë të vetme të palës paditëse për të vërtetuar se nuk i plotësonte kriteret ligjore për të fituar statusin e personave paraplegjik dhe tetraplegjik.

Komisioni Mjekësor i caktuar nga gjykata, pas ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditësit, konstatoi se paditësi F.V. hynte në kategorinë e dytë të personave paraplegjik dhe tetraplegjik. Ky konstatim u mbështet edhe nga deklaratat e tyre në seancën kryesore të mbajtur më 25 prill 2024.

Në këtë seancë, gjykata administroi provat dhe bazoi bindjen e saj kryesisht në ekspertizën mjekësore të caktuar nga ana e vet gjykatës. Gjithashtu, gjykata shqyrtoi vlerësimin e Komisionit Mjekësor të të paditurës, por meqenëse ai nuk përmbante asnjë shpjegim ose justifikim për gjendjen shëndetësore të paditësit, gjykata nuk mundi t'i falë besimin vlerësimit dhe konstatimit të këtij Komisioni.

Ndër të tjera, gjykata shqyrtoi edhe kërkesë-padinë e F.V. për njohje të së drejtës për kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik në grupin e parë, mirëpo meqenëse paditësi nuk kishte ofruar dëshmi të mjaftueshme për njohjen e kësaj të drejte në grupin e parë dhe bazuar në dispozitat përkatëse ligjore, gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e tij, duke ia njohur të drejtën për këtë pension në grupin e dytë.

Në arsyetimin e aktgjykimit të datës 30 prill 2024<sup>7</sup>, vendimet e kontestuara të MFPT-së, përmbajnë të meta që pengojnë shqyrtimin e ligjshmërisë së tyre. Këto të meta qëndrojnë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

<sup>7</sup> Vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr. 1929/2022, datë: 30.04.2024. I qasshëm te [https://pristine.gjuqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/PR\\_A\\_2022\\_161339\\_SO.pdf](https://pristine.gjuqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/PR_A_2022_161339_SO.pdf).

## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në të dy rastet e monitoruara, çështjet u sollën në gjykatë për shkak të vendimeve të paligjshme të marra nga autoriteti publik MFPT, duke përfshirë Komisionin e Ankesave. Këto vendime u bazuan në vlerësimet e Komisionit Mjekësor në kuadër të MFPT-së, të cilat nuk ofronin prova të mjaftueshme duke shkelur dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në rastin e parë, Komisioni Mjekësor gjatë procesit të rivlerësimit e kishte vendosur palën N.S. nga grupi i parë në grupin e dytë të listës së përfituesve të pensionit në bazë të Ligjit për paraplegjikët dhe tetraplegjikët. Ndërsa në rastin e dytë, pala F.V. u hoq plotësisht nga lista. Bazuar në vëzhgimet e përgjithshme gjatë monitorimit të rasteve në gjykatë, Komisioni i Ankesave të MFPT-së, megjithëse kushtetues dhe ligjërish i mandatar për të korrigjuar gabimet potenciale të shkallës së parë, në të shumtën e rasteve merr vendime që pasqyrojnë ato të shkallës së parë. Për rrjedhojë, qytetarët janë të detyruar të kërkojnë drejtësi në një nivel më të lartë, në gjykatë, ku duhet t'i nënshtrohen ekzaminimeve mjekësore shtesë nga një tjetër Komision Mjekësor të caktuar nga ana e gjykatës.

Këto vendime të paligjshme jo vetëm që po dëmtojnë palët, por gjithashtu po ngarkojnë edhe më tej gjykatat edhe ashtu të stërngarkuara, me raste shtesë. Po ashtu, po rëndojnë edhe vet autoritetin publik, pasi vendimet e gjykatës kërkojnë pagesën e interesit ligjor prej 8% për kompensim financiar.

- MFPT të ndryshojë Rregulloren, e cila do të pamundësonte rivlerësimin e personave paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë.
- Vendimet e Komisionit të Ankesave në kuadër të MFPT-së duhet të përmbajnë shpjegime të detajuara dhe arsyetime të bazuara për refuzimin e kërkesave të aplikuesve
- Institucionet relevante duhet të mbajnë përgjegjës komisionet mjekësore të MFPT-së për shkeljen e procedurave ligjore gjatë rivlerësimeve. Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative është shkelur në të dy rastet duke shkaktuar dëm për palët e prekura.